



Derbin e shqiptareve ne Europa League e kane fituar Etrit Berisha dhe Lorik Cana. Perballe kane patur Isli Hidin por 33 vjecari nuk ka luajtur dot per Apollon Limasol. Ndryshe eshte diskutimi per Etritin qe ka mundur te luaj per here te pare me skuadren italiane. Perkrahe tij ne fushe ka qene edhe Lorik Cana dhe ne fund Lazio ka fituar takimin. Tre shqiptaret e tjere qe jane ne Europe me skuadrat e tyre nuk kane luajtur. Cernomorets Odesa ka barazuar me Ludogorets ne Bullgari por as Bakaj dhe as Vangjeli nuk kane qene te grumbulluar. PAOK ka barazuar me Macabi Haifan por as Kace nuk ka qene pjese e skuadres greke ne kete ndeshje.